



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 51

Datë 15 prill 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 29/2014 datë 27.3.2014	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e neneve 25 dhe 26 të konventës “Për mbrojtjen dhe përdorimin e ujërave ndërkuftare dhe liqeneve ndërkombëtare”	2049
Ligj nr. 30/2014 datë 27.3.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ushtarak financiar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe të protokollit të zbatimit të ndihmës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë	2050
Dekret nr. 8528 datë 3.4.2014	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	2054
Vendim i ERRU nr. 6, datë 10.3.2014	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Lushnjë qytet	2055
Vendim i ERRU nr. 7, datë 10.3.2014	Për rinovim licence sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Fushë-Krujë	2055
Vendim i AMA nr. 8, datë 26.3.2014	Për një shtesë në vendimin e AMA-s nr. 5, datë 22.5.2013 “Mbi miratimin e pagesave për autorizim”	2056

LIGJ
Nr. 29/2014

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË NDRYSHIMET E NENEVE 25
DHE 26 TË KONVENTËS “PËR MBROJTJEN
DHE PËRDORIMIN E UJËRAVE
NDËRKUFITARE DHE LIQENEVE
NDËRKOMBËTARE”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në ndryshimet e neneve 25 dhe 26 të konventës “Për mbrojtjen dhe përdorimin e ujërave ndërkufitare dhe liqeneve ndërkombëtare”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 27.3.2014

Shpallur me dekretin nr. 8536, datë 8.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

KOMBET E BASHKUARA E KËSHILLI EKONOMIK DHE SOCIAL	Distrib. I PËRGJITHSHËM ECE/MP.WAT/14 12 janar 2004 ORIGJINALI ANGLISHT
--	---

KOMISIONI EKONOMIK PËR EVROPËN
MBLEDHJA E PALËVE TË KONVENTËS PËR
MBROJTJEN DHE PËRDORIMIN E UJËRAVE
NDËRKUFITARE DHE LIQENEVE
NDËRKOMBËTARE NDRYSHIMET E NENEVE 25
DHE 26 TË KONVENTËS

1. Më 28 nëntor 2003, palët e Konventës për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Ujërave Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare, ndryshuan nenet 25 dhe 26 të Konventës me vendim III/I, në vijim të një propozimi nga ana e qeverisë së Zvicrës, datë 20 gusht 2003 (shih MP.WAT/2003/4).

2. Vendimi, përfshirë në tekstin e ndryshimit, ndodhet në shtojcën më poshtë.

SHTOJCA
VENDIMI III/1
NDRYSHIMI PËR KONVENTËN E UJËRAVE

Takimi i palëve,

Duke shprehur besimin e plotë se bashkëpunimi ndërmjet shteteve breglumore në rrjedhat e ujërave ndërkufitare dhe liqeneve ndërkombëtare kontribuon në paqen dhe sigurinë dhe në menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave dhe është në të mirën e kujtdo.

Duke dëshiruar promovimin e bashkëpunimit për basenet e lumenjve në të gjithë botën dhe përfitimin nga kjo eksperiencë e të gjitha rajoneve të botës.

Duke uruar lejimin e shteteve që ndodhen jashtë rajonit të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) për t'u bërë palë të kësaj Konvente, siç është parashikuar në konventat e tjera të ambientit të UNECE (p.sh., Konventa mbi të Drejtën për Informim, Pjesëmarrjen Publike në Vendimmarrje dhe të Drejtën për Gjykim për Problemet Mjedisore dhe Konventa mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekstin Ndërkufitar), si dhe sipas protokollit të përgjegjësisë civile dhe kompensimit për dëmet e shkaktuara nga efektet ndërkufitare të aksidenteve industriale në ujërat ndërkufitare,

1. *Miraton* ndryshimet e mëposhtme të Konventës:

a) Në nenin 25, pas paragrafit 2 fusni një paragraf të ri në të cilin *thuhet*:

3. Çdo shtet tjetër, të cilit nuk i referohet paragrafi 2, që është anëtar i Kombeve të Bashkuara mund të aderohet në Konventë pas miratimit prej takimit të palëve. Në dokumentin e tij të aderimit, ky shtet do të bëjë një deklaratë, ku deklaron se miratimi për aderimin e tij në Konventë ishte marrë nga mbledhja e palëve dhe do të specifikojë datën në të cilën është marrë miratimi. Çdo kërkesë e tillë për aderim nga anëtarët e Kombeve të Bashkuara nuk do të shqyrtohet për miratim nga takimi i palëve derisa ky paragraf të ketë hyrë në fuqi për të gjitha shtetet dhe organizatat që ishin palë në Konventë, më 28 nëntor 2003.

Dhe rinumëron paragrafët që mbeten si më poshtë:

b) Në nenin 26, paragrafi 3, pas “siç i referohet në nenin 23” fusni “ose në paragrafin 3 të nenit 25”.

2. *U bën thirrje* palëve të Konventës të depozitojnë dokumentet e tyre të pranimit të amendamentit me shpejtësi.

3. *Nxit* çdo shtet ose organizatë që ratifikon, pranon ose miraton konventën të ratifikojë, pranojë ose miratojë ndryshimin e mësipërm.

4. *Inkurajon* shtetet që ndodhen jashtë rajonit të Komisionit Ekonomik për Evropën, të Kombeve të Bashkuara, në veçanti ato që kufizojnë me të, për të aderuar në Konventë dhe këtë qëllim, të kërkojnë miratimin e takimit të palëve.

5. Fton shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara të interesuara të marrin pjesë në mbledhjet e saj si vëzhgues dhe të marrin pjesë në aktivitetet sipas programit të punës së Konventës.

6. Fton shtetet kufitare në zonën e UNECE-s, që nuk e kanë bërë këtë gjë deri më tani të futen në bashkëpunim teknik, dhe marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe me shtetet breglumore të UNECE-s, në përputhje me dispozitat e pjesës II të Konventës, pa vonesë.

Kopje e njëjtë me origjinalin: XXVII. 5 b)
qershor 2006

LIGJ
Nr. 30/2014

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË
BASHKËPUNIMIT USHTARAK FINANCIAR
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË TURQISË DHE TË
PROTOKOLLIT TË ZBATIMIT TË NDIHMËS
FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
SË TURQISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e bashkëpunimit ushtarak financiar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe protokollit i zbatimit të ndihmës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 27.3.2014

Shpallur me dekretin nr. 8537, datë 8.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE

**E BASHKËPUNIMIT FINANCIAR USHTARAK
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
TURQISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Qeveria e Republikës së Turqisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (më poshtë të quajtura "Palë"t), me dëshirën për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak, brenda fushëveprimit të marrëdhënieve miqësore afatgjata, si dhe për kontributin për ristrukturimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, bien dakord për sa më poshtë:

Neni I
Qëllimi

Qeveria e Republikës së Turqisë alokon një burim financiar për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë në shumën e dollarëve amerikanë, që është ekuivalente me 2.275.000 lira turke (dy milionë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë lira turke), bazuar në bashkëpunimin financiar ushtarak. Sasia në dollarë amerikanë, ekuivalente me 1.791.000 lira turke (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë lira turke), nga ky burim financiar ofrohet për blerje të mallrave dhe shërbimeve nga kompani lokale në Turqi, kryesisht nga kompanitë e industrisë ushtarake turke për qëllime ushtarake, dhe shuma që mbetet në dollarë amerikanë, ekuivalente me 100.000 lira turke (njëqind mijë lira turke) i ofrohet pas hyrjes në fuqi të Protokollit të Zbatimit të Asistencës Financiare, që do të nënshkruhet pas konkluzioneve të kësaj Marrëveshjeje. Sasia e burimit financiar të alokuar, që arrin në shumën ekuivalente në dollarë amerikanë të sasisë prej 384.000 lira turke (treqind e tetëdhjetë e katër mijë lira turke) do të përdoret për projektin e Modernizimit të Aeroportit të Kuçovës/Shqipëri, mbi bazën e parimeve të Protokollit të Zbatimit Logjistik, i cili do të nënshkruhet veçmas ndërmjet autoriteteve të të dyja Palëve që i referohen kësaj Marrëveshjeje.

Neni II
Fusha e veprimit

Burimi financiar përfshin 10% kontribut të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që arrin shumën në dollarë amerikanë, ekuivalente me 1.990.000 lira turke (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë lira turke) i ofrohet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në formë të kontributit financiar për kostot e mallrave dhe shërbimeve që duhet të blihen për qëllime ushtarake nga kompani lokale në Turqi, kryesisht kompanitë e industrisë së mbrojtjes së Turqisë; burimi financiar shkon në shumën në dollarë amerikanë, ekuivalent me

100.000 lira turke (njëqind mijë lira turke) do t'i ofrohen në fushën e veprimit të Protokollit të Zbatimit mbi Asistencën Financiare dhe bazuar në legjislacionin përkatës të Qeverisë së Republikës së Turqisë. Sasia e burimit të alokuar, që arrin sasinë në dollarë amerikanë, ekuivalente me 384.000 lira turke (treqind e tetëdhjetë e katër mijë lira turke) do te përdoret për modernizimin e Kuçovës/Projekti i Aeroportit në Shqipëri në përputhje me parimet e Protokollit të Zbatimit Logjistik, i cili do të nënshkruhet veçmas ndërmjet autoriteteve të të dyja Palëve që i referohen kësaj Marrëveshjeje.

Neni III

Autoritetet kompetente dhe pikat e kontaktit

Kjo Marrëveshje do të zbatohet nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës së Turqisë në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pikat e Kontaktit për këtë Marrëveshje janë: Zyra e Atasheut Ushtarak të Republikës së Shqipërisë në Ankara/Turqi dhe Zyra e Atasheut Ushtarak të Republikës së Turqisë në Tiranë/Shqipëri.

Neni IV

Parimet e zbatimit

1. Në rastet e blerjes së mallrave dhe shërbimeve, për qëllime ushtarake, nga kompanitë lokale që operojnë në Turqi, kryesisht kompanitë e industrisë së mbrojtjes së turqisë, me burimin financiar që arrin shumën në dollarë amerikanë, ekuivalente me 1.791.000 lira turke (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë lira turke);

a) Nëse mallrat dhe shërbimet e blera arrijnë shumën në dollarë amerikanë ekuivalente me 1.990.000 lira turke (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë lira turke) dhe më shumë se kjo sasi, atëherë 90% e shumës së dollarëve amerikanë, ekuivalente me 1.990.000 lira turke (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë lira turke).

b) Nëse mallrat dhe shërbimet e blera janë më pak se sasia në dollarë amerikanë, ekuivalente me 1.990.000 LT (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë lira turke), 90% e sasisë së vlerës së mallrave dhe shërbimeve të blera do të ofrohen në para, bazuar në urdhrat që jepen nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës së Turqisë për Bankën Qendrore, në zbatim të parimeve të Marrëveshjes, nëpërmjet transferimit në llogarinë bankare të kompanisë nga e cila është bërë prokurimi, duke rënë dakord me Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

2. Burimi financiar i alokuar për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë do të përdoret në

vijim të nenit X të kësaj Marrëveshjeje. Sasi të e pashpenzuara do t'i kthehen Thesarit të Republikës së Turqisë.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dërgon listën e kërkesave të përcaktuara sipas burimit të alokuar (duke mbuluar, gjithashtu, prioritetet) për Ministrinë e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë, para ardhjes në Turqi për blerjet. Nën koordinimin e Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë; kompanitë përkatëse përcaktohen, dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë fillon procesin e blerjes nga kompanitë lokale në Turqi, në veçanti, nga kompanitë e industrisë së mbrojtjes së Turqisë.

4. Pagesat kryhen nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës së Turqisë në llogarinë bankare të kompanisë nga e cila është bërë prokurimi, dhe duke rënë dakord me Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë pas përmbylljes së kushteve të mëposhtme:

a) Nënshkrimi dhe përmbyllja e kontratës nëpërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë;

b) Deklarimi me notën diplomatike që mallrat dhe shërbimet e blera nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë janë marrë;

c) Deklarimi me notë diplomatike që sasia e kontributit të Republikës së Shqipërisë është paguar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

5. Në rast se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë bën një blerje që tejkalon burimin financiar të alokuar dhe sasinë e kontributit, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë duhet të transferojë një burim shtesë të kontributit të tij. Qeveria e Republikës së Turqisë nuk do të bëjë asnjë pagesë më të lartë se sasia e deklaruar në Marrëveshje.

6. Shpenzimet që lidhen direkt me alokimin e burimit financiar, si: ngarkesa, transporti, ngarkimi, paketimi, arsimimi, dietat e udhëtimit dhe pagesa ditore, sigurimi, taksat, tarifatat, detyrimet bankare dhe diferencat në kursin e këmbimit valuator, duhet të deklarohen në kontratën që lidhet ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë.

7. Vizitat, që lidhen me procesin e prokurimit, mund të fillojnë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, bazuar në nenin IX të saj. Shpenzimet e zyrtarëve të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që kanë lidhje me këtë proces, paguhet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

8. Sasia e asistencës financiare në dollarë amerikanë, ekuivalente me 100.000 lira turke (njëqind mijë lira turke) vihet në dispozicion sipas parimeve të Protokollit të Zbatimit të Asistencës Financiare, i cili do të nënshkruhet veçmas midis autoriteteve të të dyja Palëve që i referohen kësaj Marrëveshjeje.

9. Burimi financiar i alokuar nga Protokoll i Zbatimit të Asistencës Logjistike transferohet nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës së Turqisë në llogarinë bankare të Atasheut Ushtarak të Republikës së Turqisë në Tiranë/Shqipëri.

Neni V

E drejta e përdorimit për mallrat dhe shërbimet

1. Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë bie dakord të paguajë të ardhurat e fituara nga përjashtimi i mallrave dhe shërbimeve prej inventarit, të blera me burimin financiar që do të transferohet nga ana e Qeverisë së Republikës së Turqisë, në llogarinë bankare që do të caktohet nga Qeveria e Republikës së Turqisë.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë bie dakord mbi mostransferimin e mallrave dhe shërbimeve ose të drejtave të përdorimit të tyre ndaj një vendi tjetër apo Pale të tretë, pa marrë më parë njoftim me shkrim nga Qeveria e Republikës së Turqisë.

3. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojnë tek angazhimet që rrjedhin nga traktatet e tjera ndërkombëtare, ku secili prej vendeve është Palë dhe nuk do të përdoret kundër të drejtave, sigurisë dhe integritetit territorial të shteteve të tjera.

Neni VI

Siguria e informacionit të klasifikuar

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë nuk do t'i njoftojë qeverive të Palëve të Treta, për shoqëri apo persona, përmbajtjen dhe zbatimin e Protokollit ose të informacionit të klasifikuar që mund të shkëmbehet midis Palëve, pa pëlqimin me shkrim nga Qeveria e Republikës së Turqisë. Ky parim i konfidencialitetit vazhdon të zbatohet edhe pas mbarimit të Protokollit.

Neni VII

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje që mund të lindë nga zbatimi ose interpretimi i këtij Protokollit, mosmarrëveshja nuk do t'i paraqitet ndonjë Pale të Tretë, bordi arbitrazhi apo gjykate ndërkombëtare, por do të zgjidhet me përdorimin e bisedimeve nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni VIII

Rishikimi dhe amendimi

1. Secila nga Palët mund të propozojë rishikimin apo amendimin e këtij Protokollit. Në këtë rast, Palët fillojnë diskutimet jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e njoftimit me shkrim për çështjen në fjalë.

2. Amendimet e rëna dakord me shkrim ndërmjet Palëve hyjë në fuqi në përputhje me procedurën e përshkruar në nenin IX.

3. Nëse nuk arrihet rezultat brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i bisedimeve, ky Protokoll nuk do të jetë më funksional në përputhje me dispozitat e nenit X.

4. Palët vazhdojnë të plotësojnë detyrimet e tyre që rrjedhin nga ky Protokoll gjatë procesit të bisedimeve.

Neni IX

Ratifikimi dhe hyrja në fuqi

Ky Protokoll hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për mbarimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore që nevojiten për hyrjen në fuqi të Protokollit.

Neni X

Kohëzgjatja dhe mbarimi

1. Ky Protokoll do të qëndrojë në fuqi për 5 (pesë) vjet. Në rast se është përdoruar i gjithë burimi financiar, që i alokohet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, ky Protokoll do të përfundojë në datën e marrjes së njoftimit të dytë me shkrim nëpërmjet të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën për konfirmimin e situatës.

2. Në rast kur një nga Palët nuk plotëson kushtet ose konstaton se Pala tjetër nuk plotëson dispozitat e këtij Protokollit, Palët duhet të propozojnë me shkrim një konsultim midis tyre. Këto konsultime duhet të fillojnë maksimumi brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim. Nëse nuk arrihet ndonjë rezultat brenda 45 (dyzet e pesë) ditësh, secila nga Palët mund t'i japë fund këtij Protokollit brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim.

Neni XI

Teksti dhe nënshkrimi

1. Ky Protokoll është përgatitur në dy kopje origjinale në gjuhën turke, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, ku secili prej teksteve, ka të njëjtën vlerë autentike. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje që mund të rrjedhë gjatë zbatimit të këtij Protokollit, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

2. Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, duke qenë të përfaqësuar të autorizuar të dy palëve, nënshkruajnë këtë Protokoll, në datën 29 nëntor 2013, në Ankara/Republika e Turqisë.

NË EMËR TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

NËNSHKRIMI:

EMRI: SH. T

Z. Genci Muçaj

TITULLI: Ambasador i
Republikës së Shqipërisë

NË EMËR TË QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË
TURQISË

NËNSHKRIMI:

EMRI: Gjeneral Brigade

Mustafa Avci

TITULLI:

Ndihmëskoordinator dhe
Këshilltari për Teknologjinë
Ministria e Mbrojtjes

PROTOKOLLI I ZBATIMIT
PËR ASISTENCËN FINANCIARE NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TUQISË DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Qeveria e Republikës së Turqisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (më poshtë të quajtura "Palët") bien dakord mbi çështjet e mëposhtme për sa i përket asistencës financiare që jepet në kuadrin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Financiar Ushtarak, të datës

Neni I

Qëllimi

Qëllimi i këtij Protokollit është vendosja e parimeve të zbatimit të asistencës financiare në sasinë e dollarëve amerikanë, ekuivalente me 100.000 lira turke (njëqind mijë lira turke), që do të ofrohen nga Qeveria e Republikës Turke për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Neni II

Fusha e veprimit

Asistenca financiare që do të ofrohet nga Qeveria e Republikës së Turqisë do të përdoret për të plotësuar taksat e kurseve dhe shpenzimet e vizitave të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që do të vizitohen Republikën e Turqisë, si dhe pagesa të tjera financiare të tilla që mund të rrjedhin, sipas rastit.

Neni III

Parimet e zbatimit

1. Burimet e alokuara për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë do të përdoren në përputhje me nenin VIII të këtij Protokollit. Shumat e pashpenzuara i kthehen Thesarit të Republikës së Turqisë.

2. Shuma në dollarë amerikanë, ekuivalente me 100.000 lira turke (njëqind mijë lira turke) jepet për të përballuar tarifat e kurseve dhe shpenzimet e vizitave të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë që vizitohen Republikën e Turqisë, si dhe pagesa të tjera që mund të rrjedhin, sipas rastit.

Nga burimet e alokuara do të rrjedhin shpenzimet e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohen më poshtë:

a) Shpenzimet e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që do të ndjekin kurset në Qendrën e Trajnimit të Partneritetit për Paqe, Qendrën e Ekselencës për Mbrojtjen kundër Terrorizmit, si dhe Kurset e Sigurisë Detare Shumëkombëshe në sasinë e dollarëve amerikanë, që janë ekuivalente me 80.000 lira turke (tetëdhjetë mijë lira turke);

b) Shpenzimet e vizitave zyrtare të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që kryejnë vizita në Republikën e Turqisë në sasinë e dollarëve amerikanë, ekuivalente me 10.000 lira turke (dhjetë mijë lira turke);

c) Shpenzimet për të plotësuar nevoja të tjera, që mund të dalin sipas rastit në sasinë e dollarëve amerikanë, ekuivalente me 10.000 lira turke (dhjetë mijë lira turke).

3. Asistenca financiare e alokuar sipas Protokollit transferohet nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës së Turqisë në llogarinë bankare të Atasheut Ushtarak të Republikës së Turqisë në Shqipëri/Tiranë. Burimi financiar përdoret nën mbikëqyrjen e Atasheut Ushtarak të Republikës së Turqisë në Shqipëri/Tiranë në kuadrin e direktivave të dhëna nga Shtabi i Përgjithshëm i Republikës së Turqisë.

4. Kur është e nevojshme, transferimi i burimeve midis nevojave do të kryet nga Shtabi i Përgjithshëm i Republikës së Turqisë.

Neni IV

Siguria e informacionit të klasifikuar

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë nuk do t'i njoftojë qeverive të Palëve të Treta, për shoqëri apo persona, për mbajtjen dhe zbatimin e Protokollit ose të informacionit të klasifikuar, që mund të shkëmbehet ndërmjet Palëve, pa pëlqimin me shkrim nga Qeveria e Republikës së Turqisë. Ky parim i konfidencialitetit vazhdon të zbatohet edhe pas mbarimit të Protokollit.

Neni V

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje, që mund të lindë nga zbatimi ose interpretimi i këtij Protokollit, mosmarrëveshja nuk do t'i paraqitet ndonjë Palë të Tretë, bordi arbitrazhi apo gjykatë ndërkombëtare, por do të zgjidhet me përdorimin e bisedimeve nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Për sa u përket çështjeve që nuk mbulojnë nga ky Protokoll, do të zbatohen dispozitat përkatëse të "Marrëveshjes së Bashkëpunimit Financiar Ushtarak", të nënshkruar në

3. Dispozitat e këtij Protokollit nuk cenojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare të Palëve.

Neni VI
Rishikimi dhe amendimi

1. Secila nga Palët mund të propozojë rishikimin apo amendimin e këtij Protokollit. Në këtë rast, Palët do të fillojnë diskutimet jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e njoftimit me shkrim për çështjen në fjalë.

2. Amendimet e rëna dakord me shkrim ndërmjet Palëve hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e përshkruar në nenin VII.

3. Nëse nuk arrihet rezultat brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i bisedimeve, ky Protokoll nuk do të jetë më funksional në përputhje me dispozitat e nenit VIII.

4. Palët vazhdojnë të plotësojnë detyrimet e tyre që rrjedhin nga ky Protokoll gjatë procesit të bisedimeve.

Neni VII
Ratifikimi dhe hyrja në fuqi

Ky Protokoll hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet së cilës Palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për mbarimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore që nevojiten për hyrjen në fuqi të Protokollit.

Neni VIII
Kohëzgjatja dhe mbarimi

1. Ky Protokoll do të qëndrojë në fuqi për 5 (pesë) vjet. Në rast se është përdorur i gjithë burimi financiar që i alokohet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, ky Protokoll mbaron në datën e marrjes së njoftimit të dytë me shkrim nëpërmjet të cilave Palët njoftojnë njëra-tjetrën për konfirmimin e situatës.

2. Në rast kur njëra nga Palët nuk plotëson kushtet ose konstaton se Pala tjetër nuk plotëson dispozitat e këtij Protokollit, Palët duhet të propozojnë me shkrim një konsultim midis tyre. Këto konsultime duhet të fillojnë maksimumi brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim. Nëse nuk arrihet ndonjë rezultat brenda 45 (dyzetë e pesë) ditësh, secila nga Palët mund t'i japë fund këtij Protokollit brenda 60 (gjashtë dhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim.

Neni IX
Teksti dhe nënshkrimi

1. Ky Protokoll është përgatitur në dy kopje origjinale në gjuhët turke, shqipe dhe angleze, ku secili prej teksteve ka të njëjtën vlerë autentike. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje, që mund të rrjedhë gjatë

zbatimit të këtij Protokollit, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

2. Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, duke qenë të përfaqësuar të autorizuar të të dyja Palëve, nënshkruajnë këtë Protokoll, në datën 29 nëntor 2013, në Ankara/Republika e Turqisë.

NË EMËR TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

NËNSHKRIMI:
EMRI: SH.T Z.
Genci Muçaj
TITULLI: Ambasador i
Republikës së Shqipërisë

NË EMËR TË QEVERISË SË
REPUBLIKËS
SË TURQISË

NËNSHKRIMI:
EMRI: Gjeneral Brigade
Mustafa Avci
TITULLI :
Ndihmëskoordinator dhe
Këshilltar për Teknologjinë
Ministria e Mbrojtjes

DEKRET
Nr.8528, datë 3.4.2014

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Etleva Qazim Dedaj (Shushi)
2. Laureta Baftjar Grassler (Luca)
3. Alda Muharrem Shkurti (Hasa)
4. Anjeza Shyqyri Guri
5. Marie Bib Prendi (Prenga)
6. Arjan Neki Sela
7. Emirjeta Skënder Veshi
8. Sabah Destan Ponari
9. Enkelejda Hodo Doce
10. Albert Qamil Qehajaj
11. Albano Shaban Alushi
12. Dorelda Reshat Alushi (Lela)
13. Bora Skënder Lohja
14. Ira Agron Dibra
15. Adriana Çausht Malaj (Malai)
16. Sidrita Arian Alija
17. Blerti Kujtim Elbasani
18. Ilija Kristaq Fetollari
19. Xheni Latif Arbana
20. Dashmir Bajram Shehu

21. Sebastian Dashamir Shehu
22. Tobias Dashamir Shehu
23. Afrim Xhemal Qefalia
24. Altin Refik Kali
25. Erion Islam Bakalli
26. Megi Gëzim Maçe
27. Jurlind Llambi Budurushi
28. Gent Tasim Rami
29. Brunilda Shaban Khawaja (Mërlika)
30. Erjona Bashkim Schuster (Vozga)
31. Klarend Vergim Fejzulli
32. Flutura Shamet Xhufi (Tafa)
33. Vandamo Anastas Sula
34. Julian Bardhush Kocllari (Koçllari)
35. Armando Albert Riko

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 6, datë 10.3.2014

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR
KONSUM PUBLIK PËR SHA UK LUSHNJË
QYTET**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 21.3.1996 "Për kudrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, metodologjisë "Për vendosjen e tarifave", si dhe vendimit të KKRR-së nr. 35, datë 14.10.2013 "Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2014", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të sh.a. UK Lushnjë-qytet

a) **Tarifë volumetrike për shërbimet:**

	Furnizimi me ujë	Largimi i ujërave të ndotura
Konsumator familjar	54 lekë/m ³	15 lekë/m ³
Institucione buxhetore	125 lekë/m ³	20 lekë/m ³
Ente private	135 lekë/m ³	22 lekë/m ³

b) **Tarifë fikse**

Konsumator familjar	100 lekë/muaj/klient
Institucione buxhetore	200 lekë/muaj/klient

c) **Shitje uji me shumicë** 32 lekë/m³

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2014

- uji pa të ardhura (humbjet)	65 %
- niveli i matjes	99 %
- kohëzgjatja e furnizimit	8 orë/ditë
- efienca e energjisë	0.58 kWh/ m ³
- efikasiteti i stafit	5.9 p/000/lidhje
- mbulimi me ujë	85 %
- mbulimi me kanalizime	70 %
- norma e arkëtimit	85 %
- cilësia e ujit (klor + koliform)	Sipas standardeve

3. Pagesa rregullatore vjetore për sh.a. Lushnjë-qytet do të jetë 0.8% e të ardhurave të llogaritura.

4. Ky vendim hyn në fuqi, më 1.4.2014, dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

5. Vendimi i KKRR-së nr. 102, datë 7.1.2013 "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik", shfuqizohet.

KRYETAR
Avni Dervishi

VENDIM
Nr. 7, datë 10.3.2014

**PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME FUSHË-KRUJË**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për alikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik operatorit sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Fushë-Krujë me:

Drejtues ligjor	Alfred Cela
Drejtues teknik	Rexhep Llega

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës- Kanalizime Fushë-Krujë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia Fushë-Krujë.

4. Kjo licencë është e vlefshme deri në datën 2.4.2017, siç është përcaktuar me vendimin e KKRR-së nr. 18, datë 3.4.2013.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr. 8, datë 26.3.2014

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E AMA-s NR.
5, DATË 22.5.2013 “MBI MIRATIMIN E
PAGESAVE PËR AUTORIZIM”

Në mbështetje të nenit 25, pika 6 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 128 të Kodit të Procedurave Administrative, Autoriteti i Mediave Audiovizive

VENDOSI:

1. Në pikën 1.1.1 të vendimit të AMA-s nr. 5, datë 22.5.2013 “Mbi miratimin e pagesave për autorizim”, të shtohet tabela e mëposhtme me këtë përmbajtje:

“1.1.2 Masa e pagesës për autorizim për ripërsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve në zonat mbi 1 qark.

Nr.	Zona	Pagesa në lekë
1	2 qarqe deri në 4 qarqe	5 000 000
2	5 qarqe deri në 8 qarqe	7 500 000
3	9 qarqe deri në 12 qarqe	10 000 000

2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 12 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006